

*“Unë po ju them: në qiell do të ketë po kështu më shumë
gëzim për një mëkatar që pendohet e kthehet se për të
nëntëdhjetenëntë të drejtë, që s’kanë nevojë të kthehen.”*

JEZUSI I NAZARETIT – UNGJILLI SIPAS LUKËS 15, 7



Kisha ting Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 3 MARS 2017 Çmimi 30 lekë




TË KUJTOJMË
PËR TË NDËRTUAR
TË ARDHMEN
1967-2017

Martirizimi i
KISHES KATOLIKE

Kalendari Liturgjik

Prill 2017



Pas të shtunës, në të zbardhur të dritës të ditës së parë të javës, shkuan Maria Magdalenë dhe Maria tjetër për të parë varrin. Kur qe, ra një tërmet i madh, sepse engjëlli i Zotit zbriti nga qielli, u afrua, rrokullisi gurin dhe u ul mbi të. Fytyra e tij ishte porosi vetëtima e petku i tij i bardhë porsi bora. Rojtarët, prej frikës së tij, u dridhen dhe u bënë si të ishin të vdekur. Atëherë engjëlli u tha grave: “Ju mos u trembni! E di se kërkoni Jezusin e kryqëzuar! Ai nuk është këtu! U ngjall sikurse tha! Ejani e shikoni vendin ku qe vënë e pastaj nxitoni të shkoni e tregoni nxënësve të tij: u ngjall së vdekuri dhe, ja, po shkon para jush në Galile. Atje do ta shihni. Ja, ju tregova!” Ato menjëherë u larguan nga varri me frikë e njëherësh me gëzim të madh; shkuan me nxitim t’u lajmërojnë nxënësve të tij. Dhe ja, u doli Jezusi përpara e u tha: “Ju falem!” Ato u afruan, e morën ngrykë dhe e adhuruan. Atëherë Jezusi u tha: “Mos kini frikë! Shkoni e lajmëroni vëllezërit e mi të shkojnë në Galile. Atje do të më shohin.”

02 prill - E DIELA E V E KREZHMEVE (A)

09 prill - E DIELA E LARIT

13 prill - E ENJTJA E DARKËS SË ZOTIT

14 prill - E PREMTJA E MUNDIMIT TË ZOTIT

15 prill - VIGJILJA E PASHKËVE

16 prill - E DIELA E PASHKËVE

17 prill - E hëna gjatë tetëditëshit të Pashkëve

18 prill - E marta gjatë tetëditëshit të Pashkëve

19 prill - E mërkurë gjatë tetëditëshit të Pashkëve

20 prill - E enjte gjatë tetëditëshit të Pashkëve

21 prill - E premte gjatë tetëditëshit të Pashkëve

22 prill - E shtunë gjatë tetëditëshit të Pashkëve

23 prill - E DIELA II E PASHKËVE ose MËSHIRA HYJNORE

25 prill - Sh. Marku

26 prill - E DIELA IV E PASHKËVE

27 prill - ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË PAJTORJA E SHQIPNISË

29 prill - Sh. Katerina e Sienës, virgj. E mës. E k., Pajtores e Evropës

30 prill - E DIELA III E PASHKËVE

Konferenca
“Të kujtojmë për të
ndërtuar të ardhmen” *faqe 3*

Karl Marx, Enver Hoxha
dhe Besimi *faqe 3-4*

Katër vjet në timonin e
Kishës katolike!
Nga Gjergj META *faqe 5*

Sh. T. Imzot Charles John Brown
Nunci i ri Apostolik në Shqipëri *faqe 5*

Motër Maria Kaleta nderohet
me Titullin “Kryqi i Lartë
për Kishën e Papën”
Nga Violeta MARASHI *faqe 6*

Lufta kundër varfërisë dhe
përgjithimit social *faqe 7*

Kush jam unë dhe
kush dua të bëhem?
Nga Klevis PALOKA *faqe 8*

Ditar i Asamblesë së 89-të
Përgjithshme të CEEC
Nga Motër Teuta BUKA *faqe 9*

Dele të humbura,
apo ujq grabitqarë?
Nga Dom Marjan LUMÇI *faqe 10*

Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës *faqe 11*

Fal nëse don të jesh i falur *faqe 11*



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frenco

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D’Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Konferenca

“Të kujtojmë për të ndërtuar të ardhmen”

Eventi ishte shpallur me kohë dhe në të vërtetë kishte një lloj pritjeje nga ana e njerëzve që gjithsesi nuk u zhgënjye, qoftë për materialin e paraqitur e qoftë për ndërhyrjet e një niveli shumë të lartë për ngjarjen që trajtonin.

Nën moderimin e gazetarit *Alfred Lela* eventin e hapi *Imzot Gjergj Frenco*, Arqipeshkëv i Tiranë-Durrësit dhe organizuesi i kësaj veprimtarie i cili bëri një sintezë historike dhe filozofike të konceptit marksist të fesë si opium i popujve. Ai tregoi se si Enver Hoxha kishte një urrejtje të madhe ndaj fesë e sidomos ndaj katolikëve. Këtë Imzot Frenco e tregoi duke cituar vetë fjalët e Emver Hoxhës: “Hierarkët katolikë ishin njëzëz pa atdhe... Subvencionet e tyre, rrogat e çdo gjë tjetër dilnin nga grabitja që u bëhej besimtarëve në forma dhuratash e deri në detyrimin me forcë të besimtarëve për t’i lënë trashëgim kishës pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Të gjithë hierarkët e kishës katolike, nga më kryesori deri të xhakoi e te famullitari, ishin të mësuar, të shkolluar me shkollë teologjike, me disiplinë të hekurt, me metodat dhe dredhitë e shtypjes së vullnetit të njerëzve me frikën e zotit, të Krishtit dhe të apostujve.”

Më pas fjalën e morën shkurtimisht *Zonja Genta Popa* dhe *Zoti Dashnor Kaloçi*, të dy gazetarë të cilët janë edhe autorë të dokumentarit televiziv “Viti i mallkuar 1976” realizuar nga Top Media, në të cilin flitet, me anë të pamjeve dhe dokumentave, se çfarë kishte ndodhur në atë vit në luftën kundër fesë, objekteve të kultit dhe klerikëve.

Shfaqja e pjesës së parë të dokumentarit pasoi me dy ndërhyrje. Së pari e mori fjalën



gazetari i TV Klanit dhe moderator i emisionit Opinion, *Blendi Fevziu* i cili solli në vëmendjen e të gjithëve dy histori të trishta të kohës së komunizmit: historinë e Dom Shtjefën Kurtit dhe të Nënë Terezës. I pari u pushkatua për një pagëzim, ndërsa e dyta nuk u lejua të shihte nënën e saj. Ndjehej në fjalët dhe në vetë zërin e Fevziut emocioni që ai përcolli dhe që përjetoi edhe në veten e parë.

Më pas profesoreshë *Aljula Jubani* solli në vëmendjen e të gjithëve, me anë të një ligjërate të një niveli të lartë akademik, rolin e klerit dhe të

kishës në formësimin shpirtëror, kulturor dhe arsimor të shqiptarëve. Ajo, duke e nisur udhëtimin e saj historik qysh nga mesjeta, i shkoi kundër një lloj historiografie komuniste për të thënë disa të vërteta që shpeh heshten. Regjimi komunist me gjithë këtë kontributet që Kisha dhe kleri dha ndër shekuj, për ruajtjen e identiteti shpirtëror të shqiptarëve, nuk u zmbars në persekutimin e tij duke lënë gjurmë dhe pasoja të rënda në jetën dhe shpirtin e shqiptarëve.

Aktiviteti u mbyll me shfaqjen e pjesës së dytë të dokumentarit “Viti i Mallkuar 1976”.

Karl Marx, Enver Hoxha dhe Besimi

Fjala e Sh. T. Imzot George Frenco Arqipeshkëv Metropolit i Arkidioqezës Tiranë-Durrës në konferencën përkujtimore të 50 vjetorit të shpalljes së Shqipërisë vendi i parë dhe i vetëm ateist në botë.



Shprehja shumë e njohur e Karl Marx-it rreth fesë është: “Feja është opiumi i popullit” – një fjalë që Enveri e kishte shumë për zemër. Më duket se Marx ka përdorur këtë shprehje për herë të parë në Hyrjen për librin e tij “Kritika e Filozofisë së Hegel-it mbi Drejtësinë”, dhe e ka përdorur në kuptimin që feja është vegël në duart e klasës zotëruese për të sunduar klasën proletare; në këtë mënyrë, feja justifikon padrejtësitë shoqërore. Teoria e Marx-it rreth fesë tregon sa shumë paragjykime kishte ndaj fesë, veçanërisht ndaj fesë së krishterë (ndoshta si reagim për faktin se babai i tij, që ishte hebre, u detyrua të bëhej i krishterë për të shmangur persekutimin). Është shumë e çuditshme sesi Marks, i cili para se të kritikonte ligjet ekonomike dhe teoritë shoqërore të asaj kohe,

studionte mirë shkrimet e autorëve që përhapnin ideologjinë kapitaliste të asaj kohe si Adam Smith e Ricardo, nuk bëri asnjë përpjekje të tillë për doktrinën e krishterë. Po të kishte lexuar, për shembull, Ungjillin e Mateut kap. 25, Letrën e Jakobit dhe shkrimet e Shën Gjon Gojartit, do të kishte qenë më i kujdesshëm para se të kishte akuzuar fenë si “opiumi i popullit”.

Vladimir Lenin adoptoi të njëjtin pozicion si Marks për sa i përket fesë. Edhe për të, feja është opiumi i popullit. Megjithatë, në shkrimin e tij “Socializmi dhe Feja”, çuditërisht, Lenin bën këtë vërejtje shumë interesante: “Çdo njeri duhet të jetë absolutisht i lirë për të përqaftuar atë fe që i pëlqen, ose të hedhë poshtë çdo fe, domethënë të jetë ateist, si zakonisht është çdo socialist”.



Kjo do të thotë se Enver Hoxha, i cili gjithmonë mburrej se ndiqte politikën Marxiste-Leniniste, në politikën e tij rreth fesë shkoi shumë e shumë përtej qendrimit të Leninist. Dhe fatkeqësisht, Hoxha u mbyll hermetikisht jo vetëm ndaj botës perendimore, por edhe ndaj vetë mendimit komunist. Për të, mendimi komunist mori fund me Stalinin. Po të kishite lexuar, për shembull, shkrimet e marxistëve si Ernst Bloch (për të cilin feja *nuk është* opiumi i popullit), ose si Roger Garaudy (shumë i hapur për dialogun me të krishterët), ndoshta do të kishite marrë një qendrim shumë më të arsyeshëm ndaj feve.

Çdo fe, për Hoxhën, është helm për shoqërinë. Por ai ka treguar një urrejtje shumë të veçantë ndaj katolikëve. Ja fjalët e tij në një kongres: "Hierarkët katolikë ishin një rrez pa atdhe... Subvencionet e tyre, rrogat e çdo gjë tjetër dilnin nga grabitja që u bëhej besimtarëve në forma dhuratash e deri në detyrimin me forcë të besimtarëve për t'i lënë trashëgim kishës pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Të gjithë hierarkët e kishës katolike, nga më kryesori deri të xhakoi e te famullitari, ishin të mësuar, të shkolluar me shkollë teologjike, me disiplinë të hekurit, me metodat dhe dredhitë e shtypjes së vullnetit të njerëzve me frikën e Zotit, të Krishtit dhe të apostujve. Besimtarët katolikë duhej të ishin në duart e kishës *perinde ac cadaver* (lat.: *edhe si kufoma*).... Kisha katolike dhe hierarkia e saj ishin në kulm obskurantiste, konservatore, si dhe të adaptueshme e të përkulshme kur ua donte puna, por gjithmonë në alenacë me regjimin reaksionarë.... Vetëm regjimi ynë i diktaturës së proletarietit i dha fund veprimtarisë keqbërëse, reaksionare e kolaboracioniste të kishës katolike.... Kjo ishte gjendja në hierarkinë e fesë katolike dhe në besimtarët para Konferencës së Pezës. Priftërinjtë e mëdhenj ishin agjenturë e dyfishitë – e Vatikanit dhe e pushtuesve italian."

Dëshiroj tani, shkurtimisht, të theksoj rolin e fesë për rendin në shoqëri. U referohem dy pohimeve të dy personave shumë të njohur: Voltaire dhe Dostojevski. Voltaire tha: "Dua që avokati im, rrobaqepësi im, shërbëtorët e

mi, madje dhe gruaja ime, të besojnë në Zotin. Nëse ata bëjnë këtë, do të më mashtrorjnë e do të më vjedhin më pak." Ndërsa Dostojevski tha: "Nëse Zoti nuk do të ekzistonte, gjithçka do të ishte e lejueshme."

Ndoshta jo të gjithë janë dakord me Dostojevskin. Në fakt ka filozofë të cilët thonë se themeli i sjelljes morale është i pavarur nga besimi në ekzistencën e Zotit. Ndoshta për më shumë, nuk janë dakord me Voltaire-in, pasi në pohimin e tij gjejmë një shembull tipik të manipulimit të fesë. Me të drejtë Gordon Allport ka bërë dallimin ndërmjet praktikës së pjekur dhe praktikës së papjekur të fesë. Njeriu i pjekur për nga pikpamja e fesë është ai që me vërtetësi i shërben Zotit; ndërsa njeriu i papjekur është ai që përpigjet të shërbehet nga Zoti. Në këtë rast kemi të bëjmë me një manipulim të fesë dhe të besimit fetar. Megjithatë besoj se kishite të drejtë Papa Pali VI kur thonte, në Enciklikën *Populorum Progressio*: "Njeriu mund ta ndërtojë botën pa Zotin, por në këtë rast do ta ndërtonte për shkatërrimin e vet".

Personalisht jam i bindur se edukimi fetar (ose edukimi në fe) luan një rol të rëndësishëm për një rend të mirë në shoqëri. Nuk mrekullohem nëse në një dokument të shekullit të dytë, dhe pikërisht në Letrën drejtuar Diognetit, në një përshkrim të mrekullueshëm të jetës së të krishterëve, lexojmë: "Të krishterët nuk dallohen nga të tjerët as nga territori, as nga gjuha, as nga zakonet e jetës Madje as në veshje, në ushqim e në pjesën tjetër apo nga zakonet e vendit Megjithatë ata vendosin një formë jete të mrekullueshme U binden ligjeve të vendosura, por me mënyrën e tyre të jetesës janë më superiorë nga ligji".

Shën Pali u thotë Romakëve (13, 7): "Jepni gjithkujt çka i përket: tatimitarit tatimin, doganierit doganën, atij që është për t'u druajtur drojën, atij që është për nderim nderimin". Duke komentuar këtë tekst, shën Toma vëren: "Ai që do dikë, lirisht dhe me kënaqësi i jep çka i duhet, madje edhe më shumë" (*Contra Gentiles* 3, 128). Në dëshmitë e Martirëve Shilitanë (*Acta Proconsularia*, në vitin 180) lexojmë se

ata ishin qytetarë që u bindeshin ligjëve dhe paguanin tatimet; dhe këtë e thanë duke patur parasysh fjalët e sipërmendura të Palit. Speratus, udhëheqësi i grupit, tha: "Nuk kam vjedhur, dhe i paguaj tatimet..." Dhe kur e pyetën: "Çfarë ke në qese?" ai përgjigjet: "Librat dhe letrat e Palit, një burrë i drejtë".

Çdo besim i vërtetë ka jo vetëm një dimension personal, por edhe një dimension shoqëror, domethënë angazhon anëtarët për të mirën e përbashkët. Ja pse Ernst Bloch, Roger Garaudy, dhe disa komunistë të tjerë si Lombardo Radice dhe Togliatti janë shkëputur nga doktrina e Marx-it dhe e Lenin-it, që feja është opiumi i popullit. Madje, sipas Ernst Bloch, feja është shprehja e aspiratave që janë në thelbin e zemrës së njeriut. Sipas tij, feja i ngre në qiell ëndrrat më të mira të njeriut: ëndrrat për një botë më të denjë për njeriun.

Më në fund dëshiroj të kujtoj ata 38 martirë që, para katër muajsh, janë shpallur të Lumët, ndër të cilët ishin edhe tre burra besimtarë laik dhe një vajzë. Të burgosur, të torturuar barbarisht, të vrarë... e cili ishte krimi i tyre? Praktikimi i asaj feje që, sipas shokut Enver, ishte opiumi i popullit!

Dhe do të mbaroj duke ju lexuar një poezi që kishte shkruar Visar Zhiti në pranverë të vitit 1982 në burgun e Spaçit:

Kur prishën tempujt,
kryqi – si një udhëkryq i vogël –
ra brenda në shpirtin e besimtarit.
I arrestuan ikonat.
Kam njohur në burg priftërinjtë.
Që të mos kuptojnë asgjë spiunët
bisedojnë latinisht.
Ah, kjo turmë e ashpër këtu,
e paditur,
kryqëzon në kryqin e marrëzisë së vet
si Krishtin
vetveten.
Pika gjaku bien mbi bukën,
nëpër nenet e kushtetutës,
te vagonët që i shtyn me krahët tanë
dita e burgosur.
Pikëllim të përjetshëm ikonash
kanë fytyrat këtu.
Shenjtorë pa mjekra,
pa flokë
në ferrin e turmës...
Mjegull,
gjithë ajo mjegull
si tym temjani
dhe djalli s'po ikën që s'po ikën.



Katër vjet në timonin e Kishës katolike!

Nga Gjergj META

E thotë fort qartë dhe urtisht Kardinali Ernest Troshani: “Ky asht Papa që Shpirti Shenjtë ka zgjedh për kohën tonë”. Çdo krahasim nuk ka vlerë, i bërë në çfarëdolloj mënyre apo për çfarëdolloj qëllimi. Ky është Papa që Zoti ka dashur për ne në këtë kohë e që është shprehur nëpërmjet votës së Kardinajve katër vjet më pare, pikërisht më 13 mars 2013.

Në katër vjet janë katër temat themelore që Françesku, me ndjeshmërinë dhe përgjegjësinë për t’iu përgjigjur, bashkë me gjithë Kishën, misionit të saj dhe sfidave të kohës ka zgjedhur të përballojë: familja, të varfërit, mëshira dhe reformimi i kuries romake. Jemi në zemër të Ungjillit dhe kohët sot kërkojnë pikërisht këtë gjë që Papa po bën.

Dy sinode për Familjen, njëri pas tjetrit dhe një nxitje apostolike “Amoris Laetitia”, për të thënë që martesat dhe familja janë të shkruara në zemrën e çdo njeriu. Pavarësisht opinionit mediatic, që shpesh merr apekte të veçanta, duke i fryrë ato tejskajshmërisht, duhet të thuhet me bindje të plotë se Amoris Laetitia, që më në fund e kemi edhe në shqip, ka si qëllim më së pari t’i kumtojë botës Ungjillin e familjes dhe martesën si diçka të bukur. Është vizioni pozitiv dhe ideali i bukurisë së familjes që edhe sot e kësaj dite tërheq ende shumë të rinj e të reja që të ndërmarin këtë rrugëtim sa të mundimshëm aq edhe të bukur. Kur ky ideal i bukur njolloset ose rrudhet nga rrethanat, nga mëkati apo gabimet e njerëzve, nuk do të thotë se duhet të dorëzohemi, por nuk duhet të rreshtim së ndihmuari ata që kanë nevojë, familjet e plagosura,



të rrënuara e të lodhura nga barrat e jetës. E nuk duhet të rreshtim as së kumtuari përsëri e përsëri madhështinë e kësaj qelize të shoqërisë njerëzore.

Të varfërit në zemër të këtij Pontifikati qysh në ditën e parë të tij. Ah sa do të doja një Kishë të varfër për të varfërit – tha para gazetarëve të mbledhur pak ditë pas zgjedhjes së tij Papa Bergoglio! Vizita e parë si Papë brenda Italisë në Lampedusa, aty ku konsumohen tragjedi njerëzore, trafik qëniesh njerëzore, në kërkim të një jete më të mirë. E më pas udhëtimi i parë në Europë: Shqipëria, një vend i varfër dhe që kishte vuajtur kalvarin e diktaturës komuniste më të egër në Europë. E pikërisht këtu në Tiranë, në Katedralen e shën Palit, Françesku përlotet duke përfaqëuar dom Ernestin që më vonë do ta krijojë kardinal. Një kujdes i vazhdueshëm

për ata që shoqëria i përjashton apo nuk u jep të drejtën e tyre.

Mëshira e pamasë e Hyjit! Një vit kush-tuar mëshirës në të cilën Papa ftoi dhe nxiti gjithë Kishën që t’i hapte dyert e mëshirës për të gjithë ata që kanë nevojë dhe duan të gjejnë faljen e Hyjit. Nuk ka gjë që Hyji nuk mund të falë. Asnjë mëkat nuk e përmbys apo tejkalon dashurinë e Hyjit. Ftesë meshtarëve që të jenë misionarë të mëshirës dhe të faljes, por edhe bashkësive të krishtera që të jenë vatra ku falja dhe mëshira jetojnë së bashku. Shumë gjeste dhe shumë nisma në vitin e mëshirës. E në fund dyert e hapura të rrinë ashtu të hapura gjithmonë deri në fund.

Reformimi i Kuries romake. Sfidat që Papa i ka vendosur vetes qysh në fillim të Pontifikatit me krijimin e grupit të 8 kardinalëve G8 që më pas u bë G9. Dëshira për të rigjallëruar mekanizmin e një kurie që shpesh mund të kthehet më shumë në një pengesë se sa në një ndihmë. Ka ende shumë punë për t’u bërë, por reformimi më i vështirë e më i rëndësishëm, që do të ishte nëna e të gjitha reformimeve apo shëndija më e fuqishme që do të ndizte një zjarr të madh, është ai i zemrës. Do ta thotë në shumë raste këtë Papa e së fundmi edhe në takimin për urimet e Krishtlindjeve me të gjithë nënpunësit e Kuries romake. Një model edhe për Kishat locale të shpërndara në të gjithë botën. E ndoshta një model i best practice edhe për institucione të tjera që të mbytura nga burokracitë e shumta kthehen në makina të ndryshkuar pushteti.

Ad multos annos Papa Françesku e shumë urime në krye të Kishës të cilës i ke dhënë një frymëmarrje të freskët dhe të thellë!

Sh. T. Imzot Charles John Brown Nunci i ri Apostolik në Shqipëri

Imzot Charles John Brown, kryepeshkëv titullar i Aquileia, së fundmi ish Nunc Apostolik në Irlandë, nga Papa Françesku u emërua Nunci Apostolik i Shqipëri,

Jetëshkrimi i Sh. T. Imzot Charles John Brown

Lindi në New York, më 13 tetor 1959. Përfundoi studimet akademike në Histori, pranë *Universitetit të Notre Dame*, Indiana (USA) duke kryer gjithashtu Teologjinë në *Universitetin e Oxfordit* (Angli); Studimet Mesjetare në *Universitetin e Torontos* në Kanada; Teologjinë Sakramentale në Universitetin e *Shën Anselmit* në Romë.

U shugurua meshtar më 13 maj 1989, në New York në katedralen e Shën Patrikut. Nga viti 1989, deri në vitin 1991 ka qenë zv/famullitar në San Brendan, në lagjen e Bronx-it të New York-ut. Më 6 maj 2000, Imzot Charles John Brown u emërua Kapelan i Shenjtërisë së Tij, ndërsa në shtator 2009, Sekretar i Komisionit Teologjik Ndërkombëtar.

Nga viti 1994 ka qenë pjesë e Kongregatës për Doktrinën e Fesë. Një emërim i rëndësishëm, ku është aktivizuar duke marrë ngarkesën e një serie çështjesh dhe problematikash, të përfaqësimit të Selisë së Shen-

jtë në rrafshin ndërkombëtar.

Ati i Shenjtë me datë 09. 03. 2017, e emëron Imzot Charles John Brown, në postin e Nuncit Apostolik në Shqipëri. Ky emërim bëhet pas përfundimit të misionit të Imzot Ramiro Moliner Ingles, Nunc Apostolik në Republikën e Shqipërisë (më 1 shtator 2016).

Nën këndvështrimin e retrospektivës së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me Selinë e Shenjtë, për sa i përket periudhës së pasnëntëdhjetës kur nisi të ndryshojë kursi ateist i politikës së deriatëhershme shqiptare, së pari do të nënvizonim 7 shtatorin e 1991, kur rivendosën marrëdhëniet në nivel nunciature apostolike për Selinë e Shenjtë - e më pas 22 prillin e 1993, me emërimin e ambasadorit të parë për Republikën e Shqipërisë. 22 tetori 1991-shit, na kujton emërimin e Nuncit Apostolik Mons Ivan Dias, me origjinë nga India (çfarë mori edhe interpretimin mjaft domethënës, që shqiptarët i dhuruan Indisë Nënë e Madhe të të Varfërve dhe India i dhuroi Shqipërisë Nuncin Apostolik. Mons Dias (më pas Kardinal), erdhi në vendin tonë duke ia paraqitur letrat kredenciale më 18 dhjetor 1991, Presidentit të Republikës në atë kohë Z. Sali Berisha. Më pas më 22 prill 1993, Papës Gjon Pali II, Letrat kredenciale, ia dorëzoi profesor Willy Kamsi, i cili shkoi pranë



Selisë së Shenjtë me atributet e plota të ambasadorit të Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë. Fill pas kësaj ngjarje, 25 prilli 1993-shit, do të lerë gjurmët e një kulmimi të jashtëzakonshëm: Gjon Palit II me shtegtimin Apostolik shkel në tokën shqiptare, për t’i dhënë bekimin papnor. Vijmësia e raportve diplomatike, por tashmë edhe hapja plotësisht e Shqipërisë, pati një sërë momentesh të tjera, që reflekuan ngrohtësinë e afrimit të këtyre marrëdhënieve, për të kaluar tek (21 shtatori 2014), vizita tjetër Apostolike e madhështore e Papa Françeskut, i cili me përparësi veçoi vendin tonë, për t’i bërë nderimet popullit të shumëvujtur, por edhe Kishës së martirizuar tmerrësisht nga diktatura komuniste. Një përshkallëzim tjetër që merr rëndësi të madhe ka qenë shenjtërimi i Nënë Terezës, më 5 nëntorin e 2016, por edhe lumni e çuarja përpara e kauzës së shenjtërimin nga Selia e Shenjtë për 38 bijtë më të mirë të kësaj toke të martirizuar.

Motër Maria Kaleta nderohet me Titullin “Kryqi i Lartë për Kishën e Papën”

Nga Violeta MARASHI

Me kërkesën e Kuries Dioqezane të Sapës, *Ati i Shenjtë Francesku është i denjuar t'i dhurojë Motër Maria Kaletes P.F.SS. (stigmatine), Dekoraten e Kryqit të Lartë për Kishën e Papën (Pro Ecclesia et Pontifice) të themeluar kryesisht për ata që janë dalluar për (Përkushtimin, Zellin, Shërbimin) dhe angazhimin e tyre, duke i dhënë njëkohësisht mundësinë, (të drejtën) për t'a treguar këtë Dekoratë.*

Në festën e Lajmërimit të Zotit që ndryshe njihet si festa e Zojës Nunciatë, datë 25 mars 2017, nën organizimin e famullitarit Dom Vincenc Pali, bashkësia katolike e famullisë Shën Nikolli Pistull, u mbledh në kremtimin e ceremonisë së rastit.

Nderuan me praninë e tyre përfaqëuesi i Selisë së Shenjtë në vendin tonë, i ngarkuari me punë në Nunciaturën Apostolike, Mons. Romanus Mbena, meshtarë, rregulltarë e rregulltare, Nëna Gjenerale e motrave Stigmatine e ardhur enkas për këtë rast nga Italia, përfaqësues të pushtetit lokal si dhe besimtarë të shumtë.

Që në fillim të kremtimit të udhëhequr nga Administratori Dioqezan i Sapës, dom Simon Kulli, ai iu shprehi mirëseardhjen të gjithëve dhe mirënjohjen ndaj Zotit duke e falenderuar për dhuratën e jetës dhe shëndetin e plotë të Motër Maria Kaletës; për shërbimin e saj për shumë e shumë vite, e mbi të gjitha gjatë regjimit komunist; ti japim lavdi Zotit për punën dhe përkushtimin e ringjalljes së fesë në zemrat e besimtarëve në shumë fshatra të Zadrimës, punë të cilën besoj se të gjithë ju e njihni dhe e dini shumë mirë se, ajo me thjeshtësinë e saj e realizonte shpalljen e Ungjillit me shumë dashuri dhe përvujtëri. Ndërsa gjatë homelisë së rastit, dom Simoni iu drejtua Motër Mariës duke i thënë se, *veprimtarinë tënde të 45 viteve të tua në noviciat, e flet më së miri fytyra e jote e vuajtur me rrudhat e saj, sepse je munduar gjithmonë të qëndrosh afër axhes tënd, Martirit dom Ndoc Suma në vitet e vuajtjeve të tija nëpër burgje, dhe bashkëmotrës tënde martire, Marije Tuci. Ti, halla Marije siç edhe*



të thërrasin e gjithë bashkësia, je kushtuar vullnetarisht për t'iu shërbyer të gjithëve në kishë në shërbim për më të vegjëlit, të sëmurët, të vuajturit, të varfërit, në çdo aspekt, social - kulturor, në të gjitha rrethanat.

Halla Marije, si Administrator i kësaj Dioqeze e falenderoj Zotin për jetën rregulltare tënden, dhe të falenderoj Ty, për dashurinë e shprehur në vepër, për këtë vend dhe popull, kaq të vuajtur dhe uritur për Zotin. Gjatë këtyre viteve të shërbimit tënd je angazhuar që ta shuash këtë uri me Fjalën e Zotit dhe me sakramentet e shenjta.

Gjithashtu, Dom Simoni kujtoi dhe nuk mund të mos e përmendte edhe përkushtimin e saj ndaj tij dhe dom Marjan Lumçit; ndikimin që ajo pati në zbulimin e thirrjes së tyre meshtarake, dhe me përlësi iu drejtua me fjalët: **Të falem Halla Mari, që me ndihmën e Zotit dhe me lutjet tuaja që na kanë shoqëruar pa nda, ia arritëm dëshirës për të qenë një nga shërbëtorët e Zotit.**

Më pas, Mons. Romanus lexoi dekretin e dërguar nga Vatikani në të cilin shkruhej titulli zyrtar dedikuar Motër Maria Kaletës. Vetë motër Maria mes emocioneve të shumta shprehi falenderimet e saja për këtë nder dhe mirënjohje që po i bëhej, dhe me modestinë më të madhe thoshte se nuk i meritoj këto. Motër Maria Kaleta është motra stigmatine që gjatë gjithë regjimit edhe pse në fshehtësi iu përkushtua jetës së murgeshës ku pavarësisht se ka jetuar mes sakrificave, vuajtjeve e përndjekjeve, së bashku me të ka jetuar edhe “feja” pa u lëkundur asnjëherë. Ajo është një martire e gjallë e ditëve tona, që me dëshminë e saj së bashku me Kardinalin Dom Ernest Troshanin, me 24 shtator 2014 përlotën Papa Franceskun në Katedralen e Tiranës.

Sot Motër Marija gëzon plot 88 vjet. Jeta e saj është një dëshmi me plot sakrificë, dhe herë herë me sfida që ia kanë lodhur shpirtin, por nuk u dorëzua kurrë, duke u mbështetur vetëm në Jezun Krishtin.



Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social

Për një botë më të denjë për njeriun

Të premten më, 16 dhjetor 2016 në ambientet e Arqipeshkëvisë Metropolitane Tiranë-Durrës, në sallën "Imzot Rrok Mirdita", u zhvillua Konferenca e Tretë Rajonale në kuadër të projektit "Procesi i Integruar i Trajnimit, Qendrueshmëria e Caritas-eve Dioqezane në Shqipëri" me temë "Lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social, për një botë më të denjë për njeriun". Ky aktivitet u zhvillua nën kujdesit e drejtpërdrejtë të Arqipeshkëvit Metropolit Imzot George Frenzo O.P. dhe Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës.

Takimi nisi rreth orës 10:00 duke u moderuar nga znj. Paulina Hoti, pedagoge duke u shprehur mirë se ardhjen të gjithë të pranishëmve. Përshëndeti në emrin e Caritas-it Shqiptar dhe si mbështetës i projektit Dr. Albert Nikolla, i cili vuri theksin se duhen mbështetur me dashuri ungjillore këto nisma njerëzore sidomos për grupet në nevojë. Konferenca vijoi me fjalën e Imzot George Frenzo, ku në kumtesën e tij "Zgjedhja për të varfërit në Shqipëri" vuri theksin se në çdo shoqëri, të varfrit kanë qenë dhe ende janë ajo pjesë e njerëzimit që është më e pambrojtur, më e mënjanuar, dhe më e abuzuar. Një situatë e tillë është krejt në kundërshtim me atë dinjitet që gjendet brenda çdo njeriu. Duhet të dallojmë dashurinë ungjillore nga ajo mareriale... Ushqë atë që po vdes nga varfëria, sepse nëse nuk e ushqen po e vret! Nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë merre pjesë znj. Denada Dibra, drejtore e Drejtorisë së Përkujdesit Shoqërorë dhe Shërbimeve të Integruara. Në fjalën e saj qëmtoj mbi politikën sociale dhe integruarë që Qeveria dhe Ministria e linjë ka marrë në lidhje me varfërinë dhe përjashtimin social si dy nga pikat më kritike të situatës aktuale socio-ekonomike. Vlenë të përmendet se Qeveria ka rehabilituar ligje të cilat mbështesin familjet në nevojë, kur ato plotësojnë kriteret paçka se mund të jenë posedues të disa të mirave materiale që janë si rezultat i punës së bërë në vite në emigrim apo duke punuar në vend.

Z. Andi Seferi nënkryetari i Bashkisë Tiranë, shprehu gadishmërinë për mbështetjen e këtyre grupeve në nevojë dhe solli disa nga aktivitetet që ofron Bashkia Tiranë duke nisur nga banesat sociale, integrimin e komunitetit kryesisht atyre rom, rehabilitimin e zonave urbane dhe përshtatshmëria për personat me aftësi ndryshe. Ndër të tjera z. Seferi fol për bonuset që Bashkia jep për familjet e reja, ato në varfëri të skajshme në lidhje me qeratë e banesave apo edhe për kreditë me kosto të ulta. Bashkia sipas tij, është e gatshme për të bashkëpunuar me organizatat dhe të gjithë së bashku të kontribuojmë në të mirat e përbashkëta të qytetarëve të qytetit tonë.

Pjesa e dytë e takimit vijoi me realitetin dhe angazhimet e Kishës dhe misionarëve në Dioqezë. Dom Gjergj Meta, solli për të pranishmin një qasje të varfërisë dhe përjashtimit social të parë në tërësi si fenomen që gjithnjë e më shumë haset në të gjitha shoqëritë qofshin këto me ekonomi të zhvilluara apo edhe si tonat në zhvillim. Kontributi ynë duhet të jetë aktual dhe vetëm kështu kemi realizuar sado pak një nga pritshmëritë tona. Raportet e ndryshme, përqindjet që përcillen çdo ditë si nga media apo edhe nga studime të ndryshme tregojnë se vendi ynë këto dy fenomene edhe pse mundohet në të



gjitha format për ti zbutur, duhet punuar shumë mes Institucioneve publike qofshin këto lokale apo qendrore dhe organizatave bamirëse. Ndërsa motër Teuta Buka përcollti për të pranishmit vepren e tyre prej 25 vitesh të Motrave Saleziane në Shqipëri. Kontributin e tyre në rritjen dhe integritetin e vajzave, punëne parreshtur me fëmijë dhe angazhimin në jetën baritore, janë këto e shumë të tjera nga punët e tyre të pareshtura. Motër Josefina Rojo e Shoqërisë Mari, solli shembujt kontret pranë shkollës dhe kopshtit ku ato janë drejtuese. Trajtimi i fëmijëve dhe nxënësve me nevojë, apo me aftësi ndryshe, etj në mënyrë të njëjtë si gjithë fëmijët e tjerë duke pasur për synim integrimin e tyre, janë rastet konkrete që institucioni ynë arsimor preferon të mos bëj diferencime - shtoj ajo.

Pjesa e fundit e konferencës u përqendrua në punët konkrete të Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës, Caritas Shqiptar dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile. Në emër të projekti foli koordinatori Elidon Dodaj, ku solli për të pranishmit fushatën e zhvilluar përgjatë vitit 2016 në Dioqezë "Tani ngrihu: kërko, vepro, dhuro edhe ti!" ku mes të tjerat janë realizuar katër takime komunitare, mbi gjashtë fushata në terren, tre konferenca rajonale, dhjetra familje të ndihmuar me pako ushqimore, veshmbadhje dhe ilaçe - vizita në familje, takime në qendren e dëgjimit, etj. Ndërsa znj. Adela Shtjefni ekonomiste e Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës paraqiti punën e projekteve dhe miniprojekteve të Caritas në Dioqezë. Duhet vënë theksin se Caritas Dioqezan po zhvillon disa projekte dhe miniprojekte social në Dioqezë siç janë "Qendra Ditore për

fëmijë në Maminas", "Kujdesi social e shpirtërorë me të burgosurit", "Lëvizja për Jetën në mbrojtje të të palindurve dhe asistencë për nënat e reja", "Konvikti për vajzat studente", "Kurset e kuzhinës", "Kitarres dhe organos", "Rrjeti i vullnetarëve" etj. Znj. Ariela Mitri menaxhere e Caritas Shqiptarë, foli mbi angazhimin në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, grave e vajzave nga trafikimi, dhuna apo edhe format e tjera të shfrytëzimit dhe mbi çështjet tejet emergjente të momentit asaj të luftës në Siri, mbi migrimin dhe refugjatëve. Po nga Caritas Shqiptar foli znj. Enkelejda Qama menaxhere, ajo solli realitetin e mbështetjes për zhvillimin dhe fuqizimin e fëmijëve, të rinjve dhe komunitetit për një jetë më dinjitoze. Po ashtu u ndal edhe tek qendra ditore në periferi të Tiranës. Si pjesë e kësaj mbështetje dhe integrimi i ka qenë edhe angazhimi për përmbytjet e fundit të ndodhura në Tiranë kryesisht pranë bregut të lumit Tiranë. Z. Gazmir Mema nga Mary Ward Loreto përcollti për të pranishmit punën e projekteve të kësaj organizate në lidhje me disa target grupe siç janë të rinjtë në formim për profesion, integrimi i grave dhe i burrave në shoqëri - mbështetja që u jepet kryesisht këtyre grupeve në nevojë janë në një farë mënyre jo vetëm integrim por edhe një farë aftësimi për të bërë pjesë e shoqërisë larg përjashtimit social dhe varfërisë.

Koferenca përfundoi rreth orës 13:00 në një moment bashkëndarje me të gjithë të pranishmit duke reflektuar për të ardhmen dhe sa e si do duhet që të jepet në mënyra më konkrete mbështetja rreth këtyre grupeve shoqërore të cilat janë pjesa më pak e integruar e shoqërisë.



Kush jam unë dhe kush dua të bëhem?

Nga Klevis PALOKA

Me datën 18 mars 2017 në oratorin "Don Bosko", Tiranë është mbajtur takimi i dytë për formimin e të rinjve për Arqidioqezën Tiranë-Durrës, ku të pranishëm ishin rreth 130 të rinj nga famulli të ndryshme të Arqidioqezës tonë. Ky takim i dytë kishte si temë kryesore "Njohjen e Vetvetes", "Kush jam unë dhe kush dua të bëhem?".

Dita ishte e animuar nga momente të ndryshme argëtimi, e cila në pjesën më të madhe u udhëhoq nga Dom Wojtek Porada S.D.S, i cili nëpërmjet disa lojrave të ndryshme u përpoq të na mësonte sesi mund ta njihnim vetvetën tonë. Megjithëse në predikimin e tij, Dom Wojteku theksoi se "Nuk është shumë e rëndësishme që të degjojmë të gjitha fjalët që na thonë të tjerët sepse duke i bazuar nga fjalët e të tjerëve ne mund të dalim nga vetvetja. Por e rëndësishme është që ne të bëjmë atë që ndejmë pavarësisht se mund të paragjykojemi nga të tjerët, sepse nëse ne stepemi nga fjalët e të tjerëve nuk mund të japim asnjëherë më të mirën tonë. Por edhe nëse ne bazohemi nga fjalët e të tjerëve si përshembull nëse dikush na thotë që ne " kemi telefon të bukur ose vishemi bukur", ata na shikojnë thjesht si një mbajtës telefonash ose si një manekin rrobash.

Pas predikimit dha animimit nëpërmjet lojrave nga Dom Wojteku, të rinjtë u ndanë në 5 grupe në bazë të muajit të lindjes së tyre dhe iu dha një kohë rreth 60 minuta për të njohur njëri-tjetrin më mirë dhe për të diskutuar mbi temën e ditës.

Pas këtij momenti erdhi momenti më i rëndësishëm i takimit që ishte Meshja e Shenjtë e cila u udhëhoq nga Atë Laureano Del Otero Sevillano, por që ishin të pranishëm edhe disa meshtarë të tjerë. Në fund të meshës nga meshtarët u shpërnda një dhuratë simbolike, një laps i vogël që kishte mbishkrimin " ...në dorën e Zotit", që ishin të përgatitura nga Mt. Malvina Doçi.

Në fund të këtij takimi nuk mund të mungonin as zhvillimi i Kampionatit të Volejbollit dhe Futbollit midis të rinjve nga famulli të ndryshme. Takimi i tretë dhe i fundit për këtë vit do jetë me 20 maj 2017 në kishën "Zoja e Këshillit të Mirë" në Gurëz të Milotit.



Ditar i Asamblesë së 89-të Përgjithshme të CEEC (Komisioni Evropian i Edukimit Katolik) Tiranë, 24-25 mars 2017

Nga Motër Teuta Buka
Koordinatorë e Komisionit Kombëtar
të Edukimit Katolik Shqiptar

Prej shumë vitesh Komisioni ynë i edukimit katolik i drejtuar nga Imzot Massafra, President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë ka marrë pjesë në Asambletë e Komisionit Evropian të edukimit katolik si i ftuar. Duke qenë se nga 2 prill të vitit 2016 Shqipëria është anëtarësuar në këtë CEEC (Komisioni Evropian për Edukimin Katolik), me të drejta të plota, Asambleja tij e zakonshme e 89-të, për herë të parë, u zhvillua në Shqipëri. Pikërisht në datat me datat 24 dhe 25 Mars 2016 në Tiranë.

Ashtu si në shumë vende të tjera të Evropës ku dy herë në vit zhvillohet Asambleja e Përgjithshme, edhe Asambleja e Shqipërisë, ishte përveç të tjerash dhe një mundësi për të njohur realitetin e vendit në lidhje me edukimin, sistemin arsimor si dhe sfidat e tij.

24 MARS 2017

Në paraditen e së premtes me 24 mars, iu dha shumë hapësirë paraqitjes së Edukimit Katolik në Shqipëri nga ana e Komisionit tonë; duke filluar me historinë, statistikën aktuale, dhe sfidat respektivisht Atë Ronny D'alesio, Mirela Dautaj, motër Teuta Buka. Interesi i Asamblesë ishte shumë i gjallë sidomos për kontekstin tonë multi-fetar dhe të gjithë antëtarët e komisionit tonë plotësuan kuadrin e edukimit katolik në Shqipëri. Pjesa e dytë e paradites u fokusua mbi lirinë e zgjedhjes së edukimit nga ana e familjes, mbi shkollën si vend i rritjes edhe në dialog ndërftetar duke vijuar me dëshmi të ndryshme nga vende të tjera të Evropës, Portugalia, Norvegjia, Holanda, etj.

Pasditja e datës 24 ishte e menduar nga CEEC dhe Komisioni ynë si një bisedë njohjeje mes autoriteteve të Ministrisë së Arsimit dhe Komisionit Evropian. Nga Ministria e Arsimit ishte i pranishëm Zoti Pëllumb Karameta, këshilltar i ministres së Arsimit Lindita Nikolla. Ishte kënaqësi të kishim mes nesh përveç Imzot Massafres edhe Arqipeshkvin e Dioqezës Tirane e Durrës Imzot Frenon si dhe të ngarkuarin me punë në Nunciaturën apostolike Imzot Romano Mbena si provë e vullnetit të Kishës për ta venë edukimin e brezit të ri në qendër të zemrës dhe misionit të saj ungjillëzues.

Pas prezantimit të Zotit Guy Selderlagh, Sekretarit të Përgjithshëm të CEEC, mbi Edukimin Katolik në Evropë (që përfaton 8 milion nxënës), dhe pas ndërhyrjes së Zotit Karameta mbi sistemin Shkollor të Shqipërisë dhe sfidat e tij, vijoi një dialog me pjesëmarrësit. Përveç Komisionit tonë Kombëtar ishin edhe drejtuesit e shkollave dhe kopshteve tona, ekspertët në proceset që Komisioni ka ndërmarrë: si të konsulencës juridike, ekonomike, të rishikimit të programeve



dhe teksteve shkollore.

Është afër mendsh që në kaq pak kohë bisede nuk nxirren konkluzione dhe as objektivi i sessionit të hapur nuk ishte ky, por mund të themi se në diskutimet që vijuan, Ministria konfirmoi vullnetin e saj të vlerësojë burimet njerëzore dhe shpirtërore të rrjetit të shkollave tona, duke ia njohur vetes njëfarë padije në lidhje me pasurinë që rrjeti ynë përfaqëson dhe me pasionin me të cilin i dedikohet edukimit pa lënë mënjanë asnjë hallkë të tij. Natyrisht edhe propozimi i Komisionit Evropian CEEC, në lidhje me mbështetjen ekonomike që shteti, ashtu si në shumicën e vendeve të Evropës, mund të japë për pagesën e mësuesve të shkollave katolike, duke ia njohur atyre shërbimin publik që bëjnë dhe njëkohësisht duke i garantuar qytetarëve të vet lirinë e zgjedhjes, mbetet akoma pa përgjigje, por edhe nuk mund të konsiderohet si një argument që nuk mund të shikohet e diskutohet në një të ardhme jo të largët. Vizita në Shkodër që vijoi në ditën e dytë pas agjendës së mëngjesit pati disa etapa. Së pari ish hetuesia pastaj burgu dhe pastaj muzeu Dioqezan. Këto vizita u dhanë miqve tanë mundësinë për njohur periudhën e persekutimit komunist, në mënyrë të veçantë egërsinë e persekutimi ndaj Kishës Katolike. Njohja me figurat e martirëve dhe të historisë sonë, qenë për shumicën e anëtarëve të

CEEK një mundësi unike për të prekur me dorë fenë e fortë të popullit tonë, dhe kontributin që ka dhënë e jep besimi i krishterë për mbijetesën e begatinë e Kishës dhe të kombit. Në fund vizita tek ish Kolegja Saveriane, sot Gjimnazi Atë Pjetër Mëshkalla, na mbushi me shpresë për të ardhmen. Të shoqëruar nga ish nxënësit e kësaj shkolle miqtë e CEEC konstatuan se fara e mbjellë edhe pse duket se vdes, lulëzon, ndodh kështu me çdo realitet njerëzor që është i rrënjësuar në Krishtin.

Nuk mund ta mbyll pa një falënderim;

Për Imzot Massafren, për gjithë mbështetjen që na ka dhënë ne dhe shkollave tona përherë duke nxitur bashkëpunimin dhe ndihmën mes nesh. Për të gjithë drejtuesit, mësuesit e bashkëpunëtorët e shkollave tona. Për organizatën Renovabis, për mbështetjen e saj për edukimin katolik në Shqipëri dhe për organizimin e këtij eventit ne veçanti.

NJË PREMTIM

Formalizimi juridik i rrjetit tonë që ka qëlimin vetëm për të dhënë një kontribut sa më cilësor në misionin tonë të përbashkët që është edukimi në vlera të vërteta njerëzore të brezit të ardhshëm, do të jetë hapi i radhës që puna jonë të konsolidohet e të lulëzojë në të mirë të brezave të ardhshëm, të Kishës sonë dhe të Vendit tonë.



Dele të humbura, apo ujë grabitqarë?

Dëshmitarët e Jehovahit?!!!

Nga Dom Marjan LUMÇI

vijon nga numri i aluar

Pas vdekjes, Jezu Krishti u ringjall dhe u ngrit nga varri, u pa dhe u njoh nga me shumë se 500 njerëz. Ky fakt ishte vendimtar në predikimin dhe besimin e Kishës apostolike (Luka 24:39; Gjoni 2:19-21; 1 Kor 15:6, 14).

Në të kundërt, BKR&SHP mohon hyjninë e Jezu Krishtit dhe mësojnë se Jezusi është një qenie e krijuar. Ai se pari ekzistoi si Mikaeli kryeengjelli dhe me vonë u lind si një njeri i përsosur. Dëshmitarët e Jehovahit besojnë se pasi Jezusi u varros, Perëndia e rregulloi trupin e tij. Jezusi u rrit si një krijesë shpirtërore dhe "u materializua" në një trup njerëzor për ta bërë veten të dukshëm. Tani në parajsë Ai është serish i njohur si Mikaeli kryeengjell.

Shpëtimi: Bibla mëson se vdekja e Krishtit vetëm siguron zgjidhjen për problemin e mëkatit të njeriut. Jezu Krishti mori mëkatet personale të të gjithë njerëzve - në të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen - në trupin e Tij në kryq (1 Pet 2:24) dhe si një Zot i përsosur dhe si njeri i përsosur Ai plotësoi kërkesat e drejtësisë hyjnore për ne (Rom 3:22-26). Si rrjedhojë, çdo njeri ose të gjithë ata që e pranojnë Atë me besim të thjeshtë (Gjoni 1:12; Veprat 16:31), mund të falen, të deklarohen të drejte dhe të rivendosin marrëdhënien me Hyjin Atë (2 Kor 5:21; Heb 7:24-26).

Në të kundërt, BKR&SHP Mëson se vetëm një grup - elitë i Dëshmitarëve, të njohur si "të 144000", ose të "vajasurit" njohin tashme drejtësinë e Krishtit. Vetëm të 144.000 janë të rilindur dhe presin të sundojnë me Krishtin në parrizë. Për masën tjetër të Dëshmitarëve të Jehovahit, të njohur si "dele t e tjera" ose "masa e madhe", sakrificat e mundimshme e Krishtit vetëm siguron një shans për jetë të përjetshme në tokë.

Bibla gjithashtu, mëson se jemi të shpëtuar nga hiri, e shkëputur nga punët tona të mira, shëlbimi është dhuratë e Hyjit. Në nuk mund të bëjmë asnjë gjë që të kontribuojmë në shëlbimin tonë sepse, të shkëputur nga Jezu Krishti, ne jemi "të vdekur në mëkatet tona" (Efesianëve 2: 1-9).

Në të kundërt, BKR&SHP mëson se duhet të fitojmë shpëtimin tonë; shpëtimi do të "varet nga punët e çdo njerit". Një njeri mund "të vijë se pari tek organizata e Jehovahit për shpëtim" dhe të pajtohet me çdo gjë që ata mësojnë. Në këtë mënyrë, një marrëdhënie me organizatën e Dëshmitarëve të Jehovahit më mirë se një marrëdhënie personale me Jezu Krishtin, paraqitet si bazë e shpëtimit.

SHPIRTI I NJERIUT DHE NDËRSHKIMI I PËRJETSHËM.

Bibla mëson se shpirti vazhdon të ekzistojë në mënyrë të ndërgjegjshme pas vdekjes (Luka 16:19-31; 2 Kor 5:6,8, Filip. 1:23-24; Zbulesa 6:9-11). Ata që kanë hedhur poshtë dhuratën e Hyjit për jetën e përjetshme do të vuajnë të ndërgjegjshëm ndëshkimin e përjetshëm. (Mt 25:41,46; Zbulesa 14:10,11; 20:10,15).

Në të kundërt, BKR&SHP Mëshon ndëshkimin e përjetshëm dhe mëson se njeriu nuk ka një shpirt që mbijeton pas vdekjes së trupit, Dëshmitarët besojnë se vdekja i jep fund çdo ekzistence të ndërgjegjshme. Ferri i referohet varrit dhe ata që janë në fund të gjykuar nga Perëndia do të zhduken dhe thjesht do të pushojnë së ekzistuari.

Bibla. Bibla mëson se forcimi me Shpirtin e Shenjtë i jep mundësi çdo të krishteri të kuptojë Fjalën e Zotit dhe ta zbatojë atë si duhet në jetën e tij (Gj. 16: 13; 1 Gj. 2:27).

Në të kundërt, BKR&SHP mëson se Bibla mund të interpretohet vetëm nga Shoqëria Kulla e Rojës dhe asnjë individ nuk mund të mësojë të vërtetën i shkëputur nga ajo

Shoqëria K.R pretendon se është organizata e Jehovahit dhe kanali i vetëm i Hyjit për udhëzime shpirtërore në ditët e sotme.

KONTRADITA DHE NDRYSHIME

BKR&SHP thekson se Bibla është një "libër organizativ" dhe nuk mund të kuptohet nga individë, pavarësisht se sa të sinqerte janë ata. Par si mund t'ia besojmë fatin tone të përjetshëm një organizate e cila gjate kohës se shkurtër të ekzistencës se saj, ka akumuluar një histori kaq të trishtuar me kontradikta dhe ndryshime? Le të studiojmë shembujt e mëposhtëm të KR.

Me 1975 BKR&SHP mëson se njeriu i cili mbjell farën si në shëmbëlltyrën e farës së sinapit (Mateu 13) është Satani. Nga fundi i po këtij viti ata mësonin se ky mbjellës ishte Jezusi.

Një incident i ngjashëm ndodhi me 1978, kur BKR&SHP identifikuan "Alfa dhe Omega" të Zbulesës 22: 12-13, si Jehova (ky është Perëndia-Atë) dhe pesë javë më vonë mësojnë se këto vargje i referohen Jezusit.

Dështimi i shoqatës Kulla e Rojës për të interpretuar në mënyrë korrekte Biblën shihet me qartë në ndryshimet e shpeshta doktrinale. Në fillim ata mësojnë pozicionin A, pastaj kalojnë në pozicionin B, duke pretenduar se Perëndia u ka dhënë "një Ditë të re". Mirëpo më vonë, ata kthehen tek mësimi i vjetër (pozicioni A) dhe në disa raste kthehen përsëri tek pozicioni B. Ja disa shembuj.

Ringjallja e Njerëzve të Sodomës.

Në vitin 1879- Ata do të Ringjallen
Në vitin 1952- Ata nuk do të Ringjallen
Në vitin 1965- Ata do të Ringjallen
Në vitin 1988- Ata nuk do të Ringjallen.

Fjala "Zoti" tek Romakët 10:12-16,

Në vitin 1903- "Zoti" i referohet Jezusit
Në vitin 1940- "Zoti" i referohet Jehovahit
Në vitin 1978- "Zoti" i referohet Jezusit
Në vitin 1980- "Zoti" i referohet Jehovahit.

Fraza "Pushtetet e Sipërme" tek Romakët 13:1.

Në vitin 1913- "Pushtetet e Sipërme" i referohet qeverive

Në vitin 1943- "Pushtetet e Sipërme" i

referohet Perëndisë Jehova dhe Jezu Krishtit

Në vitin 1964- "Pushtetet e Sipërme" i referohet qeverive.

Ndarja e "deleve dhe e cjepërve" (Mat 25:31-46).

Në vitin 1919 - Do të ndodhë pas vuajtjeve

Në vitin 1923 - Po ndodh tani, para vuajtjeve

Në vitin 1995 - Do të ndodhë pas vuajtjeve.

PERFUNDIMI

Nën dritën e fakteve të mësipërme, a duhet të besojmë Biblës se Kullës së Rojës dhe Shoqërisë se Pamfleteve?

Ata kanë parashikuar të paktën 6 herë mbarimin e fundit të batës dhe i kanë përdorur këto parashikime për të frikësuar ndjekësit e tyre. Bibla na paralajmëron se kanë për të ardhur shumë profetë të rreme që do të pohojnë se flasin për Hyjin (Mateu 7: 15; 1 Gjoni 4: 1). Fatmirësisht jep edhe një test të mire për të identifikuar profetët e rremë. Tek Ligji i Përtërirë 18:21-22 na thuhet se kushdo që e shpall veten se po flet si një profet i Perëndisë dhe parashikon diçka që nuk ndodh është një profet i rremë:

Ju mund t'i thoni vetes, "Si mund ta dimë që një mesazh nuk është dhënë nga Zoti? Ne qoftë se shpallja e një profeti ne emër të Zotit nuk realizohet ose ndodh, ai është një mesazh që nuk e ka dhënë Zoti. Ai profet ka folur kotësira. Mos kini frike nga ai.

Sipas Biblës, një profeci e rreme e bën folësin profet të rreme. Nga ky provim, Shoqëria Kulla e Rojës dështoi në profecitë në lidhje me 1914, 1915, 1918, 1920, 1925, dhe 1975 duke provuar pa dyshim që është një profet i rreme.

Ky grup në mënyrë të vazhdueshme ka ndryshuar doktrinat e tij, të gjitha këto janë thënë dhe në të njëjtën kohë kanë pretenduar se vetëm ata e kanë të gjithë të vërtetën. A është kjo e pajtueshme me përsosmërinë dhe shenjtërinë e Hyjit Atë?

Unë nuk dua të vë në lojë ose të uli vlerat e individëve të Dëshmitarëve të Jehovahit; ata janë në përgjithësi të sinqertë dhe njerëz të përkushtuar. Në një kuptim ata janë më tepër si dele të humbura se sa ujë grabitqarë, për faktin se ata janë mashtruar nga një organizate në një histori plot profeci dhe doktrina të rreme. Dëshmitarët e Jehovahit vërtetë besojnë se po u larguan nga Shoqata Kulla e Rojës ata do të shkatërrohen në kohën e Armagedonit. Ata kanë nevojë për dashurinë dhe tu tregojmë të vërtetën.

Dëshira e jonë për ta, ashtu si për çdo njeri tjetër, është që ata të njohin të vërtetën që na mëson Bibla dhe të kuptojnë se shëlbimi është dhuratë e Hyjit-Atë për ne. Vetëm duke hyrë në një marrëdhënie personale me Jezu Krishtin dhe në Kishën të cilën ai vetë e deshi dhe e themeloi mbi apostujt, çdonjërit prej nesh do ti sigurohet falja nga mëkatet dhe Jeta e Pasosun.

Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës

Ditën e Premte me datë 5 Mars 2017, në ambientet e Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës, u realizua prezantimi i Projektit "Të gjithë së bashku mundemi", cikli i dytë në Dioqezën tonë, i cili konsiston në zhvillimin e kursit të muzikës të instrumentit të Pianos dhe Kitarës. Në këtë takim ishin të pranishëm rreth 20 persona, prindër e fëmijë të famullive të ndryshme të Tiranës dhe jo vetëm, të interesuar për këtë kurs edukativ për fëmijët, të afërmit si edhe për veten e tyre. Kauza e këtij projekti, si dhe nga vetë emri është që nëpërmjet edukimit muzikorë të krijojmë dhe të rrisim një shoqëri më të mirë për të gjithë ne. Personat që do të trajnohen në këtë kurs do të kenë mundësi të angazhohen në jetën bariore të famullive por dhe në krijimin e bandave të vogla muzikore, ku mund të luajnë në vënde të ndryshme. Në pjesën e parë të takimit u fol rreth procedimit të zhvillimit të projektit i cili do të jetë për rreth 7 muaj.

Profesorët prezantuan programin e tyre, i cili do të zhvillohet 2 herë në javë në grupe të vogla të përbërë nga 4-5 persona. E veçanta e këtij kursi është që përveç fëmijëve të interesur janë edhe grupmosha të tjera si adoleshent, të rinj dhe të rriturve. Ky projekt u prit shumë entuziazëm nga të gjithë të pranishmit dhe



pritet që së shpejti të nis si dhe të zgjerohet në më shumë me të mëdha.

Në vetvete ky kurs përtej përgatitjes së instrumentave muzikor të pianos dhe kitarës, por dhe të angazhimit në jetën baritore të famullive ka vënë në vetvete një qëllim të rëndësishëm; mbledhjen e fondeve për familjet në nevojë të Dioqezës ku pjesëtarët e kursit

do të kontribuojnë për ecurinë e kursit si një formë bashkëfinancim mes fondeve të nxitura nga projekti "Preces i Integruar i Trajnimit, Qendrueshmëria e Caritas-eve Dioqezane në Shqipëri" me fonde të Bashkëpunimit Gjerman, Renovabis, Porticus dhe Caritas Dioqezan Tiranë-Durrës.

Fal nëse don të jesh i falur Do falësh nëse më parë e ke ndjerë faljen

Një ditë para disa kohësh, një njeri, i mbushur në zemrën e tij me hidhërim, ishte duke ecur në pyll. Duke menduar për jetën e tij, ai mendonte për gjërat e tij që nuk kishin vajtur ashtu siç duheshin. Ai mendonte për ata persona që e kishin gënjyer tek shefi kundër tij, kur ishte në atë punë.

Mendimet e tij u kthyen në ata që i kishin vjedhur gjërat e tij dhe e kishin mashtruar atë. Ai kujtoi familjen e tij që se kishte më. Mendja e tij u kthye në sëmundjen që kishte, se askush nuk mund ta shërojë. Shpirti i tij ishte shumë i mbushur me zemërim, pakënaqësi dhe zhgënjim.

Duke qëndruar aty, pa gjetur një përgjigje, duke ditur gjithçka tjetër kishte qenë dështim, ai u gjuhëzua në rrëzë të një lisi të vjetër për të kërkuar Atë që ai e dinte se gjithmonë do të jetë pranë tij. Dhe me lot në sytë e tij, ai u lut: "Zot, ti ke bërë gjëra të mrekullueshme për mua në këtë jetë. Më ke thënë shumë gjëra që të bëja për ty, dhe unë të jam bindur me kënaqësi. Ti më ke thënë që unë duhet të fal të tjerët. Por unë jam i trishtuar, o Zot, sepse unë nuk mundem. Kjo nuk është e drejtë Zot, unë nuk e meritoj

këto gjëra që janë bërë kundër meje dhe unë skam pse ti fal ata. Rruga jote është e përsosur Zot, por kjo është një gjë që unë nuk mund ta bëjë, sepse unë nuk mundem dot më ti fal. Zemërimi im është aq i thellë Zot, ndoshta nuk mund të dëgjoj Zot ty, por më mëso një gjë që unë nuk mundem, më mëso si të fal"

Si u gjuhëzua atje në hijen e qetë të atij lisi të vjetër, ai ndjeu rënien e diçkaje mbi shpatullat e tij. Ai hapi sytë e tij. Nga këndi i një syri, ai pa diçka të kuqe në këmbë të tij. Ai nuk arrinte të dallonte mirë se çfarë ishte sepse pema e lisi ishte një copë e madhe katrore e drurit në tokë. Ai ngriti kokën e tij dhe pa dy këmbët të mbajtura në dru me një gozhdë të madhe nëpërmjet tyre.

Ai ngriti kokën e tij më sipër, dhe lot i dolën në sytë e tij si e pa Jezusin varur në një kryq. Ai pa gozhdën në duart e tij, një plagë në anën e tij, një trup të goditur, dhe ferrat thellë zhytur në kokën e Tij. Së fundi ai pa vuajtjen dhe dhimbjen në fytyrën e tij të çmuar. Si sytë e tyre u takuan, lotët e njeriut u kthyen në ngashërim, dhe Jezusi filloi të flasë: "A keni thënë ndonjëherë një gënjeshtëri?" Pyeti ai? Njeriu u përgjigj: - "Po, o Zot". "A të është dhënë më tepër kusur para se ç' duhet dhe e

ke mbajtur atë duke mos e kthyer? Njeriu u përgjigj: - "Po o Zot." Dhe njeriu u ngashërua gjithnjë e më shumë. "A ke marrë ndonjëherë diçka nga puna që nuk ishte juaja?" E pyeti Jezusi? Dhe njeriu u përgjigj: "Po, o Zot". "A je betuar ndonjëherë, duke përdorur emrin e Atit tim kot?" Njeriu, duke qarë, iu përgjigj - "Po, o Zot".

Si Jezusi po e pyeste akoma më shumë, a ke bërë ndonjëherë këtë gjë ose atë?" Lotët e njeriut u bënë të pakontrollueshëm, sa që ai vetëm mund të përgjigjej - "Po, o Zot".

Atëherë Jezusi e ktheu kokën nga njëra anë në tjetrën, dhe njeriu ndjeu rënien e diçkaje mbi shpatullat e tij në krahun tjetër, ai shikoi dhe pa se ishte gjaku i Jezusit. Kur ai u ktheu kokën përsëri, sytë e tij takuan ato të Jezusit, dhe ishte një vështrim i dashurisë që njeriu kurrë nuk e kishte parë apo njohur më parë.

Jezusi tha: - "As unë nuk e meritoja këtë, por unë të kam falur."

Mund të duket e vështirë kur jeni duke kaluar diçka, por Jezusi tha tek ungjilli i shën Mateut 28:20- dhe "duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës". Amen



Çmimi i shëlbimit

Nga Labeat

Një ditë, një prift i një famullie të vogël, duke hy në kishë për me kremtue Meshën shkoi drejt elterit duke mbajtur në dorë një kafaz zogjsh i cili ishte i vjetër dhe krejt i ndryshkun dhe e vendosi afër ambonit ku do të delte mandej për me prediku.

Menjëherë mbas leximit të ungjillit, Prifti e filloi predikimin e tij duke ju treguar besimtarëve për kafazin dhe historinë e tij: "Dje, duke ba një shëtitje të vogël në fshat, pashë një djalë që kishte në dorë këtë kafaz. Në kafaz ishin disa zogj të strukur afër njëri tjetrit dhe dukej qartë se ishin shumë të frikësuem. U ndala dhe e pyeta djaloshin: Biri im, çfarë ke ndërmend të bash me këta zogj që duken kështu të frikësuem? Do luaj me ta, mu përgjigj djalë. Argëtohem shumë me ta... i ngacmoj... do ju shkuli dalë nga dalë të gjitha puplat... kënaqem kur reagojnë... fillojnë të bërtasin me të madhe me zërin e tyre të hollë... vuajnë... fillojnë dhe ngatërrohen dhe ata mes tyre... e di mirë sepse e kam bërë dhe herë të tjera këtë gjë... argëtohem shumë padre!".

Atëherë, unë i çuditun nga gjithë kjo e pyeta: po pse ban këtë gja? Ata shumë shpejt do të ngordhin dhe ti nuk do ti kesh ma, dhe do të shkëputesh prej tyre? Po, e di, u përgjigj djali. Por... unë do gjej prapë zogj të tjerë, dhe këta kur të jenë të lodhur fare dhe duke ngordhur u jap

ti hanë maçokët që kam në shtëpi, sepse atyre u pëlqejnë shumë zogjtë.

Mbeta shumë i habitun dhe i tmerruem në të njëjtën kohë nga gjithë sa djali më tha.

Atëherë i'u drejtova djalit duke i thanë: sa lek do që të mi japësh mua këta zogj? Po çka të duhen Padre, këta nuk janë gardalina apo zogj të tjerë që këndojnë? Këta janë zogj fushe dhe nuk të shërbejnë për asgjë! Sa lek don dhe mi jep, i thashë përsëri?! Duke e mendue ashtu çmimin e zogjve, djali menjëherë e tha çmimin: 1000 lek të reja. Në rregull i thashë menjëherë dhe unë. Pazari u ba. Ai mori 1000 lekët, i futi në xhep dhe u zhduk si vetëtimta. Unë e mora kafazin në dorë, u'a hapa derën dhe i lashë të lirë zogjtë që të iknin.

Pasi, pra, Prifti ua sqaroi se pse e kishte atë kafaz afër ambonit dhe pas një pauzë të shkurtër, filloi përsëri të flasë: "Një ditë djalli dhe Jezusi po bisedonin së bashku. Djalli sapo ishte kthyer prej tokës, ishte shumë i kënaqur dhe i mbushur me mendjemadhësi. I'u drejtua Jezusit duke i thanë: sapo e kam pushtuar gjithë njerëzimin. Kam përdorë një kurth ndaj të cilit e dija se askush nuk do të mund të rezistonte dhe një karrem që e dija se ishte perfekt për ta... dhe i kam kapë të gjithë!". Po, çka do të bësh me këta njerëz?, e pyeti Jezusi. Djalli i përgjigj: do të

kaloj kohën duke u tallë me ta! Do ti mësoj ata se si të martohen dhe se si shpejt të ndahen; si të dashurojnë dhe si të tradhtojnë; si të bëjnë qejf dhe si të abortojnë; si të urrejnë dhe si të bëjnë keq njeni-tjetrit; si të dehen dhe si të shajnë; do tu mësoj atyre të prodhojnë armë për luftë në mënyrë që të vriten mes tyre... do të tallem e do të kaloj kohën kështu në këtë mënyrë me ta!".

"Por shpejt do të lodhesh! E kur të lodhesh, çdo të bësh me këta njerëz?", e pyeti Jezusi. "Do ti vras! Do ti marr me vete në ferr", - e ngriti plot krenari djalli zërin.

"Sa është çmimi i tyre, që ti mos ta bësh këtë gjë?", e pyeti atëherë Jezusi.

Djali i'u përgjigj: "Çka po thue? Çka të duhen ata njerëz, janë shumë të kqinj... ti dhe mund ti marrësh, por edhe ty kanë për të urreyer, kanë për të të pështy, kanë me të sha e kanë me të vra... ti nuk mundesh me i dashtë ata!".

"Po të them çka dhe sa don për ta?", e pyeti përsëri Jezusi.

Djali, me bindje të plotë se Jezusi do të hiqte dorë nga kjo gjë i tha: "Dua gjithë gjakun tand, gjithë lotët e tu... dua jetën tande!".

Jezusi, pa u mendue aspak i përgjigj: "PAZARI I KRYEM. Do ta paguaj këtë çmim.

Atëherë prifti mori kafazin dhe u largua prej ambonit...

...çmimi i Shëlbimit tonë nuk asht pague me ar dhe argjend, gjana që janë të kalueshme në këtë botë; jeni shëlbue me gjakun paçmueshëm të Krishtit. Ai është sakrifikue për ju si një qengj i pastër e panjollë. (1Pt, 18b-19)